

S T A T U T

I SHOQERISE AKSIONARE “ALBTURIST Tour - Operator” sh.a.

PËRKUFIZIMI, EMËRTIMI DHE BAZA LIGJORE

N E N I 1

Shoqeria “ALBTURIST Tour - Operator ” sh.a. është person juridik themeluar në bazë të vendimit për regjistrim nr 26539 datë 25/10/2001 te Gjykatës së Rrethit Tirane si dhe aktit të themelimit datë 22.10.2001 me aksionar të vetëm Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarjes, në rolin e **AKSIONARIT TË VETËM**, e perfaqesuar nga titullari saj, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarjes.

N E N I 2

“ALBTURIST Tour - Operator ” ka formen e një shoqerie anonime, e cila themelohet nga aksionari i vetëm Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarjes, kapitali i së ciles eshte i ndarë në aksione të nënëshkruara nga themeluesi dhe qe mbalon humbjet deri ne kufirin e vleres se pashlyer te aksioneve te nënshkruara.

N E N I 3

Baza ligjore e themelimit dhe veprimtaria e shoqerise do te regullohet nga ky statut, nga dispozitat perkatese te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqërite Tregëtare”, nga ligji nr 9723 datë 03/05/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe nga legislacioni shqiptar ne fuqi.

Shoqeria do te filloje te veproje si person juridik qe nga dita e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregetar te Shoqerive Tregetare prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit Tirane, ndersa veprimtaria ekonomike e saj fillon me rregjistrimin ne organet tatimore.

EMËRTIMI DHE SELIA E SHOQERISE **N E N I 4**

Emërtimi i shoqërise është “ALBTURIST Tour - Operator ” sh.a.

Në të gjitha aktet ose dokumentat që do të nxjerë shoqëria, shenohet emri i plote sipas citimit te mesipërm ose i shkurtuar në formën “ALBTURIST T - O ” sh.a. Ne regjistrin tregetar nuk jane regjistruar shenja dalluese te veprimtarise.

Shoqeria ka vulen e saj, forma dhe permbajtja e se ciles percaktohet nga aksionari i vetëm.

N E N I 5

Veprimitaria e shoqerise eshte e transferueshme vetem me miratim te aksionarit Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarjes, dhe ne nje rast te tille mund te perdoret emri i meparshem, si dhe titullaret e rind jane te detyruar te trashegojne te gjitha detyrimet tregetare te meparshme.

N E N I 6

Selia e shoqerise do te jete ne qytetin e Tiranes, me adresë kryesore Rruga e Kavajës, pranë njësisë bashkiake nr.7 Tirane. Adrese dytesore nuk ka.
Ndryshimi i selise behet me vendim te ortakut.

N E N I 7

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte pa afat te caktuar.

N e n i 8

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :

Administrimi i veprimtarisë turistike dhe sherbimeve rjedhese, si trashegimtare e te gjithe te drejtave aksionare te ish ndermarjes Albturist, ushtrimin e te drejtes te veprimtarise tregetare te kontratave te emfiteozes ose te qirase per objektet turistike shteterore dhe te privatizuara, ish prone e shoqerise.

Brenda kritereve ligjore qe parashikon legjislationi ne fuqi, do te kryeje operacione tregetare dhe financiare te drejtperdrejta apo te terthorta qe lidhen me objektin e saj. Kjo parashikon hapjen e veprimtarive te reja, krijimin e shoqerive te reja si dhe pjesemarjen ne kapitalin e shoqerive te tjera brenda vendit.

N E N I 9

KAPITALI THEMELTAR

Vlera e Kapitalit themeltar te nënshkruar është 90.501.565 leke. Ai perbehet nga 90501 aksione me vlore 1000 (Njëmijë) leke secili.

E gjithe kuota e mesiperme e kapitalit te nenshkuar zotërohet tërësisht në masën 100% nga aksionari i vetem, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarjes. Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit filletar te shoqerise, behet me vendim te aksionarit te vetem.

Kapitali themeltar i shoqerise depozitohet para fillimit te aktivitetit te shoqerise.

N E N I 10

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organet drejtuese te shoqerise jane :

1. Asamblea e Pergjithshme (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarjes ne rolin e Aksionarit të vetëm)
2. Keshilli Mbikqyres
3. Administratori

Administratori i shoqerise emerohet z.Pavlina Konini

N E N I 11

ASAMBLEA E PERGJITHSHME

Asamblea e Pergjithshme perbehet nga titullari i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarjes, Ministri, ne rolin e aksionerit te vetem. Ai

mer vendime ne lidhje me :

- Percaktimin e politikave tregetare
- Ndryshime ne statut
- Emerimin dhe shkarkimin e antareve te Keshillit Mbikqyres
- Shkarkimin e administratorit në rast se humbet besimin
- Emerimin dhe shkarkimin e likuidatoreve dhe eksperteve kontabel te shoqerise
- Caktimin e shperblimeve te subjekteve te sipercituar
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te ecurise se veprimtarise
- Shperndarjen e fitimit dhe zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise

KESHILLI MBIKQYRES

N E N I 12

EMERIMI DHE PERBERJA

Keshilli Mbikqyres i shoqerise emerohet nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarjes, ne rolin e aksionarit te vetem te shoqerise.

Ai perbehet nga 3 (tre) anetare me nje kohezgjatje prej 4 vjetesh, me te drejte rizgjidhje me nje mandat te dyte. Nuk mund te zgjidhen anetare te Keshillit Mbikqyres personat qe kryejne

funksione administritimi, sikurse jane administratoret e shoqerise, administratoret e shoqerive te tjera me vartesi institucionale te njeje, si dhe persona te tjere te lidhur me personat e mesiperm.

N E N I 13

KRYETARI DHE ZEVENDESKRYETARI I KESHILLIT MBIKQYRES

Keshilli Mbikqyres zgjedh ndermjet anetareve te tij nje kryetar dhe nje zv.kryetar, me votim te fshehte, te cilet zgjidhen per te gjithe kohen e mandatit te tyre dhe jane te rizgjedhshem. Neqoftese gjate votimit te pare per zgjedhjen e tyre rezultojne te tre me vota te barabarta, atehere ne votimin e dyte caktohen per kandidim me short dy nga tre anetaret, dhe nqs edhe ne votimin e dyte rezultojne me vota te barabarta te dy kandidatet, atehere kryetari caktohet me short. Personi i dyte qe del nga shorti per caktimin e kryetarit emerohet zv.kryetar. Keshilli Mbikqyres, nese e sheh te arsyeshme, mund te emeroje nje person jashtje anetareve te tij, ne postin e sekretarit te Keshillit Mbikqyres. Detyrat e sekretarit percaktohen ne regulloren e brendeshme te ushtrimit te veprimtarise te shoqerise.

N E N I 14

KOMPETENCAT E KESHILLIT MBIKQYRES

Keshilli Mbikqyres i shoqerise ka keto kompetencia:

- Kontrollon dhe mbikqyr zbatimin e politikave tregëtare të shoqërise, zbaton vendimet e asamblese si dhe i rekomandon kesaj te fundit marjen e masave per problemet e mbarevajtjes se aktivitetit te shoqerise.
- Kerkon thirjen e Asamblese se pergjithshme sa here qe ajo e sheh te domosdoshme per marjen e vendimeve qe jane kompetence e saj.
- Shqyrton dhe kontrollon librat dhe dokumentacionin kontabel duke u kujdesur qe shoqeria te respekoje standartet nderkombetare te kontabilitetit (SNK), si dhe te sigurohet se raportimi i pasqyrave financiare dhe auditimi i tyre kryhet ne menyre korrekte dhe periodike vjetore, nga eksperte kontabel te pavarur.
- Emëron dhe shkarkon administratorin e shoqerise si dhe cakton shperblimin e tij. Ajo e therret atë sa herë e vlerëson të nevojshme.
- Raporton Asamblesë së Përgjithshme (Ministrat të Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes) dhe kërkon marjen e masave urgjente nga ky i fundit, në rast se humbja e shoqërise kalon 50 % të kapitalit të regjistruar, kur aktivet e shoqerisë nuk mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve.
- Kërkon mbledhjen e Asamblesë së Pergjithshme dhe paraqet raportin e ekspertit kontabël të autorizuar i pavarur, me anë të të cilit kërkon miratimin e saj (Asamblese) në rastet kur shoqeria kerkon të shesë apo të disponojë aktive me një vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë; si dhe në rast se shoqëria duhet te blejë pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 % të këtyre aseteve.

N E N I 15

MARJA E VENDIMEVE NGA ANA E KESHILLIT MBIKQYRES

Keshilli Mbikqyres zhvillon mbledhjet e tij kur ne te marin pjese jo me pak se dy anetare te tij. Ai thirret nga kryetari dhe ne rast mungese apo tentative per te penguar veprimtarine nga ana e tij, mbledhjet e Keshillit Mbikqyres mund te thirren dhe drejtohen nga zv. Kryetari.

Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres mund te zhvillohen ne seline e shoquerise, si dhe ne cdo ambjent tjeter qe ploteson kriteret e organizimit dhe zhvillimit te nje evenimenti te tille. Njoftimi i anetareve per mbledhje mund te behet ne forme shkresore, formale apo elektronike. Ne cdo rast perjegjesine e njofitimit e ka personi qe therret mbledhjen.

Vendimet e Keshillit Mbikqyres jane te vlefshme vetem kur meren me shumicen e anetareve te zgjedhur. Marja e vendimeve duhet te shoqerohet me regjistrimin e tyre ne regjistrin e celur per kete qellim, dhe duhet te jete i firmosur nga te tre anetaret e Keshillit Mbikqyres. Ne rast kontestimi nga njeri prej anetareve do te shoqerohet me shenimin refuzon firmen.

Zbardhja e vendimit te mare do te kryhet nga kryetari i Keshillit Mbikqyres, dhe ne rast refuzimi nga ky i fundit, nga zv. Kryetari, shoqueruar me shenimin "kryetari refuzon".

ADMINISTRATORI

N E N I 16

EMERIMI

Administratori vendoset në detyrë nga Keshilli Mbikqyres, sipas propozimit per emerimin nga ana e Asamblese se Pergjithshme (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarjes), kur per te jane dakord jo me pak se dy anetare te asmablese.

Ai nuk mund te ushtroje njekohesish kete funksion ne dy shoperi te ndryshme, dhe nuk mund te kryeje asnje veprimtari tjeter publike.

Nuk mund te emerohet administrator asnjë person i denuar per vepra penale, neqoftese nuk kane kaluar te pakten 5 vjet nga dita e perfundimit te denimit.

Mandati i Administratorit nuk mund të jetë më i gjatë se 3 (tre) vjet. Ai ka të drejtën e rizgjedhjes në këtë detyrë.

N E N I 17

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka keto kompetencia:

- Drejton shoqerine dhe mer vendime per zbatimin e politikave tregetare ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe me statutin.
- Nenshkruan mareveshje dhe lidh kontrata me subjekte juridike dhe fizike qe kane te bejne me mbarevajtjen e veprimtarise te shoquerise, por asnjehere jashte kompetencave qe i atribuohen nga aktet ligjore dhe nenligjore.
- Harton regulloren e brendëshme te organizimit dhe funksionimit te shoquerise dhe mer masa per respektimin e saj.

- Pergjigjet per hartimin e programit ekonomik per vitin ushtrimor dhe projekt planin per periudhat e ardhshme, pergatit pasqyrat financiare dhe librat kontabel sipas standarteve nderkombetare te kontabilitetit dhe ja paraqet ato per shqyrtim te metejshem Keshillit Mbikqyres.
- Pergatit dhe i propozon per miratim Keshillit Mbikqyres strukturen dhe organiken e nevojshme, ne perputhje me priorititetet e zhvillimit te shoqerise, si dhe shperblimin e tyre.
- Raporton ne menyre periodike ose, me kerkesen e Keshillit Mbikqyres ne cdo kohe, rezultatet paraprake dhe masat qe duhet te meren per zhvillim te metejshem.
- Perfaqeson ligjerisht shoqerine ne mardhenie me te tretet dhe mund te zgjedhe perfaqesues me prokure ne ceshtje gjyquesore, qe kane te bejne me mosmareveshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimitarise.
- Është pergjegjes i drejtperdrejte per mbajtjen e mardhenieve dhe respektimin e kompetencave qe i jep ligji dhe statuti, ne raportet me Keshillin Mbikqyres dhe Asamblene e Pergjithshme. Ai duhet te njoftoje menjehere eproret e vet ne rast konstatimi te cenimit te ketyre mardhenieve.

EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

N E N I 18

Kontrolli finansiar i shoqerise mund te ushtrohet nga 1 (nje) ose me shume eksperte kontabel te autorizuar, te cilet emerohen nga ortaku i vetem Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarjes, dhe qe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin 10091 date 05.03.2009, “*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistik te miratuar*”.

N E N I 19

Eksperti kontabel gjate kryerjes se auditimit duhet te jete i pavarur nga organet drejtuese te shoqerise dhe per periudhen gjate te ciles kryen auditimin, nuk mund te jete pjese e vendimarjes nga kjo e fundit. Pavaresia e auditimit eshte e lidhur me konfliktin e interesit, qe ka te beje me lidhje te terthorta apo te drejtperdrejta financiare, biznesi apo punesimi ndermjet ekspertit dhe shoqerise.

Ne cdo rast qe konstatohet cenimi i kesaj pavaresie kur procesi ka filluar, shoqeria duhet te rifilloje auditimin nga e para me nje ekspert te ri kontabel.

N E N I 20

Kontrolli finansiar parashikon auditimin ligjor te pasqyrave financiare te viti ushtrimor dhe eshte auditim i pavarur, i detyrueshem dhe i kryer nga persona ose shoqeri auditimi te paisur me license te posacme per kete qellim. Viti ushtrimor eshte ai kalendarik dhe fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti.

N E N I 21

INVENTARI – LLOGARITE VJETORE

Shoqeria mban kontabilitet te regullt te pasurise dhe te veprimtarise se saj. Mbajtja e kontabilitetit duhet ti permbahet regjistrimit sipas regullave, metodave dhe teknikave kontabel të veprimeve qe kryhen dhe ngjarjeve qe i ndodhin shoquerise gjate ushtrimit te veprimtarise, te cilat sjellin ndryshime ne pasurine ose ne gjendjen financiare te tij.

Ne daten 31 Dhjetor te cdo viti ajo detyrohet te nxjere inventarin e gjendjeve ne kete date dhe ta pasqyroje ne raportimet vjetore.

Ne mbyllje te ushtrimit, brenda afateve ligjore, shoqeria percatit llogarite vjetore si dhe reportin e administrimit per gjendjen e shoquerise gjate vitit ushtrimor.

N E N I 22

REZULTATI FINANCIAR DHE PERCAKTIMI I FITIMIT

Rezultati percaktohet si diferenca ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te vitit ushtrimor, pasi te jene zbritur humbjet e periudhave te meparshme.

Nga fitimi i ushtrimit krijohet fondi rezerve ne masen 5 % e fitimit te mbetur te vitit ushtrimor. Perdorimi i ketij fondi behet vetem me urdher te aksionarit te vetem, Ministrit te Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes.

N E N I 23

SHPERBERJA E SHOQERISE

Veprimtaria e shoquerise mbaron me vendim te organit drejtues, ne rast se veprimtaria e saj nuk rezulton fitim prurese si dhe per shkaqe te parashikuara ne ligj.

Shoqeria mund te mbaroje dhe me ane te riorganizimit, nepermjet thithjes apo bashkimit.

N E N I 24

ZGJIDHJA E MOSMAREVESHJEVE

Mosmareveshjet ne mardheniet me persona juridike apo fizike vendas apo te huaj , si regull, zgjidhen me mareveshje mes paleve, ne rast te kundert me rruge gjyqesore. Gjykata kompetente per zgjidhjen e mosmareveshjeve eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane. Ky nen nuk perjashton legitimimin teritorial te gjykimit, sipas percaktiveve te bera ne Kodin Procedurave Civile.

DISPOZITA TE FUNDIT

N E N I 25

Ky statut i referohet ligjit nr 9901 date 14/04/2008 "Për Tregetaret dhe shoqerite tregetare", Kodit Civil si dhe legjislacionit Shqiptar te fushes. Cdo dispozite apo germe e statutit qe bie ne kundershtim me kete ligj apo qe nuk eshte shprehur ne kete statut, detyrimisht do te konsiderohet i plotesuar sipas kerkesave te vete ligjit.

S/
AKSIONARI I VETËM

MINISTRI

Arben AHMETAJ

22/9/2017

